



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 27450/1 Prot.

Tiranë, më 05/12 2017

**Lënda:** Njoftim për miratimin e Udhëzimit “Mbi kushtet dhe procedurat për trajtimin tarifor favorizues”

**TË GJITHË DEGËVE DOGANORE  
TË GJITHA AGJENCIVE DOGANORE  
TË GJITHË DREJTORIVE NË DPD**

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për njohje dhe zbatim Udhëzimin “Mbi kushtet dhe procedurat për trajtimin tarifor favorizues”

Këtë udhëzim, e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 27450 Prot

Tirane, 05/12 / 2017

U D H Ë Z I M

Nr. 10 datë 05/12/2017

**MBI KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR TRAJTIMIN TARIFOR FAVORIZUES**

Mbështetur në nenin 27, 28 dhe pikën 2, të nenit 56, të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Në zbatim të nenit 14 deri 32, nenit 91 dhe nenit 737, të Vendimit nr.651, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar;

Bazuar në pikën 1/b/i, të pjesës VIII/I, të Vendimit nr.921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar;

Me qëllim zbatimin korrekt dhe unifikues të Trajtimit Tarifor Favorizues (TTF);

Me synim lehtësimin e procedurave për importimin dhe konfirmimin e natyrës së mallrave me TTF nga autoritetet përgjegjëse;

U D H Ë Z O J :

**I. KUSHTET E PËRGJITHSHME**

1. Kodet tarifore për të cilat zbatohet TTF<sup>ja</sup>, janë të evidentuara në Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave në fuqi, me shenjën (\*) dhe shënimin përkatës.
2. Mbajtësi i autorizimit TTF, është i detyruar t'i përdorë mallrat për qëllimin e caktuar, të mbajë regjistra për mallrat e importuara me autorizimin TTF dhe t'i mundësojë autoritetet e doganore kryerjen e çdo kontrolli dokumentar, fizik ose analizave laboratorike.
3. Të gjitha mallrat duhet të përdoren për qëllimin e veçantë të caktuar brenda afatit të përcaktuar në autorizimin e TTF<sup>së</sup>.

4. Mbajtësi i autorizimit duhet të njoftojë autoritetet doganore për të gjithë faktorët që lindin pas dhënies së autorizimit dhe që mund të ndikojnë në vijueshmérinë e tij.
5. Mallrat e vendosura në qarkullim të lirë, me detyrime importi të reduktuara ose zero, për arsyen përdorimit të veçantë të tyre, mbeten nën mbikëqyrjen doganore. Kjo mbikëqyrje përfundon në rastet e mëposhtme:
  - Kur përmbushet afati i mbikëqyrjes së TTF<sup>\*st</sup> dhe lëshohet garancia e mbajtur (nëse plotësohen kushtet dhe dokumentacioni i përcaktuar në këtë udhëzim);
  - Kur kushtet përfitimin e detyrimeve të reduktuara ose zero pushojnë se ekzistuari dhe paguhen detyrimet doganore përkatëse;
  - Kur mallrat eksportohen ose asgjesohen;
  - Kur lejohet përdorimi i mallrave për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara për zbatimin e taksës se reduktuar ose zero dhe paguhen detyrimet doganore përkatëse.
6. TTF quhet i mbyllur, kur autoritetet doganore binden se mallrat e importuara janë përdorur për qëllimin e caktuar.
7. Me qëllim përshtypjen e procedurave të zhdoganimit, deklarata e eksportit dhe dokumentacioni i transportit mund të mos kërkohet të depozitohet paraprakisht (në momentin e aplikimit për autorizimin TTF), por duhet të jetë pjesë e praktikës doganore në momentin që mallrat janë në Degë Doganore.
8. Modeli i autorizimit TTF<sup>\*st</sup>, për rastet e mëposhtëm II-A dhe të II-B, do të jetë sipas formatit të Aneksit 1, bashkëngjitur, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi. Modeli i autorizimit të TTF<sup>\*st</sup>, për rastet II-C, do të jetë sipas formatit të Aneksit 2, bashkëngjitur, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
9. Në rast se autorizimi është lëshuar vetëm për një import, afati i autorizimit TTF, është deri ne datën kur prilet të mbërrrijë ngarkesa. Nëse autorizimi është lëshuar për një sasi krerësh, të parashikuar për t'u importuar në disa ngarkesa të mëvonshme, afati mund të jetë më i gjatë, por jo më shumë se një vit.
10. Aplikimi dhe autorizimi TTF, mbështeten në dispozitat e përgjithshme të përcaktuara në Nënsekcionin 1 dhe 2, Seksioni 2, Kreu 2, të Vendimit nr.651, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar (Kodi Doganor).
11. Autorizimet TTF, dërgohen në rrugë elektronike (*e-mail:s\_tarifa@dogana.gov.al*), pranë Drejtorisë së Tarifës dhe Originës, Sektori i Tarifës, në Drejtoren e Përgjithshme të Doganave (DPD), për t'u regjistruar në sistemin informatik të Doganës.
12. Bazuar në nenin 45, të Kodit Doganor, aplikuesi/mbajtësi i autorizimit, ka të drejtë të ankimojë vendimet e marra nga autoritetet doganore për refuzimin e një aplikimi apo vendimin për anulimin ose revokimin e një autorizimi TTF.

## **II. KUSHTE TË VEÇANTA**

### **A. Kafshët e racës së pastër për riprodhim ose përmajmëri dhe vezë për çelje**

1. Personi i interesuar paraqet, para ose në momentin e importit, në Dega Doganore aplikimin për TTF, sipas formatit të Aneksit 3, bashkëngjitur, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi. Aplikimi duhet të përbajë emrin dhe adresën e kërkuesit, numrin e NUIS<sup>ii</sup>, adresën e ambientit të mbarështimit ose majmërisë, kodin tarifor dhe sasinë e kafshëve të cilat do të importohen.
2. Aplikimit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet shoqëruar të importit dhe konkretisht:
  - *fatura proformë / fatura;*
  - *çertifikata fitosanitare (nga vendi eksportues);*
  - *lista e detauar me të dhënat për emrin, moshën, mbarëse apo jo (për kafshët);*
  - *garancia bankare.*
3. Aplikimi për autorizim së bashku me dokumentacionin shqyrtohet me prioritet nga Dega Doganore dhe nëse është e rregullt lëshon autorizimin TTF. Në rast refuzimi të miratimit kërkuesi njoftohet me shkrim menjëherë për arsyet e këtij refuzimi në përputhje me nenin 27 dhe 28 të Kodit Doganor. Personi i interesuar mund të ankohet, pranë DPD, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. DPD vendos brenda 30 ditëve për pranimin ose jo të ankimit.
4. Kafshët e gjalla, duhet të përdoren për qëllimin e veçantë të caktuar brenda afatit të parashikuar në Nenin 91(2) të VKM nr.651, datë 10.11.2017 dhe të përcaktuar në pikën 6, të autorizimit.
5. Kafshët e gjalla dhe dokumentacioni i tyre i nënshtrohen gjithmonë kontrollit nga autoriteti kompetent veterinar, në përputhje me ligjin nr.10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar”, të ndryshuar.
6. Importi i mallrave me TTF, garantohet në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor. Shuma e garancisë llogaritet si diferençë ndërmjet detyrimeve doganore që do të kishte malli pa trajtimin tarifor favorizues dhe detyrimeve që operatori ekonomik/subjekti paguan me trajtim tarifor favorizues.
7. Dokumentacioni shoqëruar, i detyrueshëm për t'u plotësuar në sistemin informatik të Doganës, (Asycuda World), në momentin e deklarimit, sipas kodeve të dokumenteve, është si vijon:

430	<i>Garancia bankare;</i>
853	<i>Certifikata veterinare nga autoriteti kompetent;</i>
928	<i>Autorizimi i TTF.</i>
8. Dega Doganore për çdo operator ekonomik (subjekt) që ka përfituar autorizim TTF, krijon dosje të veçantë e cila duhet të përbajë:
  - *një kopje të autorizimit;*
  - *Licencën e QKL, që duhet të merret nga portali përkatës;*
  - *garancinë bankare;*
  - *kartelën e të dhënavëve të kafshëve të gjalla;*

- *formularët (procesverbalet) e inspektorit të kontrollit veterinar;*
  - *të gjitha akt-kontrollet e kryera në lidhje me mbikëqyrjen e TTF në fjalë.*
9. Trajtimi tarifor favorizues i mallrave konsiderohet i mbyllur, me përbushjen e afatit të mbikëqyrjes përcaktuar në pikën 6, të autorizimit TTF dhe me dorëzimin pranë Degës Doganore të Vërtetimit të Kontrollit Fizik të Kafshëve, me numrat e matrikulimit, të lëshuar nga struktura kompetente. Ky vërtetim konfirmon nëse kafshët janë gjallë dhe janë përdorur për qëllimin e riprodhimit ose majmërisë.
10. Në rastet e “therjeve të detyrueshme” (*kur therja është e pashmangshme për shkak të ndonjë sëmundje, ose shkak i njohur si i tillë nga autoriteti veterinar*) Dega Doganore duhet të depozitojë në dosjen e saj dhe procesverbalet përkatës të therjes të detyrueshme.
11. Dega Doganore çliron garancinë, nëse Vërtetimi nga autoriteti kompetent, është në përputhje me importin e mallrave me TTF.
- B. Fara për mbjellje**
1. Importimi i çdo materiali mbjellës bimor, për qëllime shumëzimi dhe tregimi në territorin e Republikës së Shqipërisë, lejohet të bëhet nga cilido operator ekonomik/subjekt i licencuar për këtë qëllim.
2. Aprovimi i autorizimit TTF për fara për mbjellje, kryhet me procedurë të thjeshtuar. Personi i interesuar paraqet para apo në momentin e importit pranë Degës Doganore aplikimin për TTF, sipas formatit të Aneksit 3, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi. Aplikimi duhet të përbajë emrin dhe adresën e kërkuesit, numrin e NIPT-it, kodin tarifor dhe sasinë e farave për mbjellje të cilat do të importohen.
3. Aplikimit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet shoqërues të importit dhe konkretisht:
- *fatura proformë / fatura;*
  - *çertifikata fitosanitare;*
  - *dokumentacioni me treguesit cilësor të materialit mbjellës bimor.*
4. Farat për mbjellje i nënshtrohen gjithmonë kontrollit të inspektorit të autoritetit kompetent, në përputhje me ligjin nr. 9362, datë 24.3.2005 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”, të ndryshuar.
5. Dokumentacioni shoqërues, i detyrueshëm për t'u plotësuar në sistemin Asycuda World, në momentin e deklarimit, sipas kodeve të dokumenteve, është si vijon:
- 853 *Dokumentacioni për llojin e mallit dhe aprovimin e importit nga autoriteti kompetent;*  
928 *Autorizimi i TTF.*
6. Dega Doganore duhet të marrë nga portali përkatës dhe t'ja bashkëngjis praktikës doganore licencën e QKL për importuesin e farave.
7. Në rast refuzimi të miratimit të autorizimit, kërkuesi njostohet me shkrim menjëherë për arsyet e këtij refuzimi në përputhje me nenin 27 dhe 28 të Kodit Doganor. Personi i

interesuar mund të ankohet, pranë DPD, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. DPD vndos brenda 30 ditëve për pranimin ose jo të ankimit.

### C. Mallra industriale

1. Për kodet tarifore të kapitullit 25 të NKM e në vijim, aplikimi për autorizim TTF i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (Departamenti Teknik). Aplikimi sipas formatit të Aneksit 4, bashkëngjitur, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, duhet të përmbajë:
  - emrin dhe adresën e kërkuesit;
  - numrin e NUIS<sup>ii</sup>;
  - adresën e ambientit të repartit të përpunimit apo të montimit;
  - një përshtrim përbledhës të impianteve dhe procesit teknologjik sipas rastit;
  - sasinë e mallrave që do të përdoren për një periudhë të caktuar;
  - kodin tarifor të mallit që do të importohet me TTF;
  - llojin, sasinë dhe përshtimin tarifor të mallrave të përfshuara;
  - koeficentët e shfrytëzimit;
  - llojin dhe përqindjen e mbetjeve apo humbjeve teknologjike apo natyrore;
  - kohën e nevojshme për përpunimin e tij.
2. Aplikimit duhet t'i bashkëngjitet:
  - një skemë me vendosjen e makinerive të linjës së prodhimit në formën e një Gen-Plani (në momentin e kërkesës së parë);
  - kapaciteti prodhues i linjës, në formën e një studimi nga inxhinierë të miratuar;
  - lëndët e para të nevojshme për prodhimin e produktit të gatshëm;
  - firot apo koeficentët e shfrytëzimit;
  - kapacitetin prodhues të linjës;
  - dokumente të tjera si patenta, regjistrim marke, fotografi të linjës së prodhimit, ilustrime të ndryshme për produktet, kontrata furnizimi apo shitje;
  - dokumentacionin shoqëruesh të importit;
  - fatura proformë / fatura e importit;
  - garancia bankare.
3. Autorizimi i TTF-së, jepet nëse ofrohen të gjitha garancitë e nevojshme për kryerjen si duhet të përpunimit si dhe nëse autoritetet doganore mund të mbikëqyrin e kontrollojnë TTF.
4. Importi i mallrave me TTF, garantohet në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor. Shuma e garancisë llogaritet si diferençë ndërmjet detyrimeve doganore që do të kishte malli pa trajtimin tarifor favorizues dhe detyrimeve që operatori ekonomik/subjekti paguan sipas trajtimit tarifor favorizues.
5. Në rast refuzimi, në përputhje me nenin 27 dhe 28 të Kodit Doganor, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, njofton me shkrim personin e interesuar për arsyet e refuzimit të TTF<sup>ii</sup>. Personi i interesuar mund të ankohet, pranë DPD, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. DPD vndos brenda 30 ditëve për pranimin ose jo të ankimit.

6. Dega Doganore mbikëqyrëse për këto raste autorizimi TTF, merr mostra (sipas analizës së riskut, për ato mallra të cilat mund të analizohen) si për lëndët e para të importuara dhe për produktet pas përpunimit.
7. Dega Doganore kryen kontolle dokumentare, fizike, periodike apo të papritura me qëllim që të sigurohet se mallrat e çliruara për qarkullim të lirë me TTF, janë përdorur për qëllimin e caktuar.
8. Dokumentacioni shoqëruar, i detyrueshëm për t'u plotësuar në sistemin Asycuda World, në momentin e deklarimit, sipas kodeve të dokumenteve, është:
- |     |                             |
|-----|-----------------------------|
| 928 | <i>Autorizimi i TTF-së;</i> |
| 430 | <i>Garancia bankare.</i>    |
9. TTF konsiderohet i myllur, me përbushjen e afatit të mbikëqyrjes përcaktuar në pikën 7 të autorizimit TTF dhe dërgimin nga dega doganore mbikëqyrëse të :
- Çertifikatës apo certifikatave të klasifikimit tarifor të mallit, lëshuar nga Drejtoria e Laboratorit Doganor.
  - Informacion mbi sasitë e përpunuara, gjendjen e përpunuuar ose jo, si dhe mënyrën e zbatimit të TTF<sup>së</sup> (për mallrat të cilat i nënshtrohen një përpunimi të caktuar)
10. Departamenti Teknik njofton Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës (në DPD) për të çliruar garancinë në rast se të dhënat e Autorizimi TTF të lëshuar janë në përputhje me dokumentacionin e përmendur në pikën 8, pjesa II(C).

### III. DISPOZITA TË FUNDIT

Udhëzimi nr.6, datë, 13.06.2014 "Mbi Kushtet dhe Procedurat për Trajtimin Tarifor Favorizues, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE**

*Dega Doganore* \_\_\_\_\_

Nr. Prot.

, më 201\_\_\_\_\_

**Autorizim Trajtimi Tarifor Favorizues Nr.\_\_\_\_\_**

**1. Mbajtesi i Autorizimit:**

*Emri:*

*Nipti:*

**2. Adresa e plotë e mbarështimit / majmërisë / çeljes së vezëve**

**3. Natyra e përdorimit final**

**4. Periudha e vlefshmërisë së autorizimit**

*Ky autorizim është i vlefshëm deri më ... / ... / ...*

**5. Mallrat të cilat do të vendosen nën mbikëqyrje doganore:**

Kodi tarifor	Përshkrimi	Sasia

**6. Periudha e mbikëqyrjes doganore**

*Deri në datë ... / ... / ...*

**7. Garancia bankare**

*Shuma: (me numra dhe fjalë)*

**8. Identifikimi i përdorimit të veçantë:**

*Nëpërmjet Vërtetimit të Autoritetit Kompetent*

**Shënim :** Mbajtësi i autorizimit duhet të njoftoj autoritetin doganore nëse ndryshon një apo disa nga kushtet e autorizimit.

**KRYETARI I DEGËS DOGANORE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI TEKNIK  
DREJTORIA E TARIFËS DHE ORIGJINËS

Nr. Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_

**Autorizim Trajtimi Tarifor Favorizues Nr.\_\_\_\_\_**

**1. Mbajtësi i Autorizimit:**

*Emri:*

*Nipti:*

**2. Adresa e plotë**

**3. Natyra e përdorimit final**

**4. Periudha e vlefshmërisë së autorizimit**

*Ky autorizim është i vlefshëm deri më ... / ... / ...*

**5. Mallrat të cilat do të vendosen nën mbikëqyrje doganore:**

Kodi tarifor	Përshkrim i	Sasia

**6. Kodi ne DAV Rubrika 37/b: 009**

**7. Periudha e mbikëqyrjes doganore**

*Deri në datë ... / ... / ...*

**8. Garancia bankare**

*Shuma: (e percaktuar me numra dhe fjalë)*

**9. Zyra Doganore e mbikëqyrjes: \_\_\_\_\_**

**10. Identifikimi i përdorimit të veçantë:**

*Nëpërmjet certifikatës së klasifikimit tarifor nga Drejtoria e Laboratorit Doganor*

*Shënim : Mbajtësi i autorizimit duhet të njoftoj autoritetin doganore nëse ndryshon një apo disa nga kushtet e autorizimit.*

**ZV. DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

### Anekxi 3

Drejtar: Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave  
*Degës Doganore*

Lënda: Aplikim për Trajtim Tarifor Favorizues

Unë i nënshkruari, ..... me Nr. NUIS<sup>i</sup>: ..... dhe me adresë

kërkoj miratimin për Trajtim Tarifor Favorizues, si vijon:

1. Mallrat të cilat do të vendosen nën mbikëqyrje doganore me TTF:

Kodi tarifor	Përshkrim i	Sasia

2. Natyra e perdonimit final .....
3. Periudha kohore e përpunimit .....
4. Periudha kohore e autorizimit .....
5. Dokumentet bashkëngjitur:

1. ....
2. ....
3. ....
4. ....
5. ....
6. ....
7. ....
8. ....
9. ....

**ADMINISTRATORI**

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

## Aneksi 4

**Drejtuar:** Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave  
*Departamenti Teknik*  
*Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës*  
*Sektorit të Tarifës*

**Lënda:** Aplikim për Trajtim Tarifor Favorizues

Unë i nëshkruari, ..... me Nr. NIPT-i: ..... dhe me adresë .....  
kërkoj miratimin për Trajtim Tarifor Favorizues, si vijon:

1. Mallrat të cilat do të vendosen nën mbikëqyrje doganore me TTF :

Kodi tarifor	Përshkrimi	Sasia

2. Përshkrimi përbledhës përpunimit, trajtimit .....

.....  
.....  
.....

3. Natyra e perdonimit final .....

.....

4. Zyra e Mbikqyrjes Doganore .....

5. Koeficienti i shfrytëzimit .....

6. Lloji dhe përqindja e mbetjeve/humbjeve .....

7. Periudha kohore e përpunimit .....

8. Periudha kohore e autorizimit .....

9. Dokumentet bashkëngjitur:

1. ....
2. ....
3. ....
4. ....
5. ....
6. ....
7. ....
8. ....
9. ....

**ADMINISTRATORI**

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_